

Lejet e Ndërtimit

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadate Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	3
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Elma Çali
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ecali@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	28.02.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	28.02.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	28.02.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara ofrojnë informacion për ndërtesat dhe punimet inxhinierike në nivel vendi. Informacioni statistikor rreth lejeve të ndërtimit të miratuara është një tregues afatshkurtër i cili paraqet zhvillimin e sektorit të ndërtimit në periudhën pasardhëse. Të dhënat të cilat INSTAT grumbullon dhe publikon mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri gjithsej i lejeve të ndërtimit të miratuara (ndërtesa rezidente dhe jo rezidente); • Sipërfaqja gjithsej në metra katrorë e lejeve të ndërtimit të miratuara (ndërtesa

	<p>rezidente dhe jo rezidente);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa (ndërtesa rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike; • Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa sipas klientit (ndërtesa rezidente dhe jo rezidente) dhe punime inxhinierike.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i Llojeve të Ndërtimit (1998)
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhëna mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara, të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve.</p> <p>Ndërtesat rezidente janë ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit do të shfrytëzohet për qëllime banimi.</p> <p>Ndërtesat jo rezidente janë ndërtime ku të paktën gjysma e sipërfaqes së objektit nuk do të shfrytëzohet për qëllime banimi.</p> <p>Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katror ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.</p> <p>Punime inxhinierike janë të gjitha ndërtimet e pa klasifikuara në ndërtesa si: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.</p> <p>Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore janë ndërtesat rezidenciale dhe jo-rezidenciale për të cilat është miratuar leje ndërtimi. Punimet inxhinierike për të cilat janë miratuar leje ndërtimi.
3.6. Popullata statistikore	Të gjitha ndërtesat dhe punimet inxhinierike për të cilat është miratuar një leje ndërtimi.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e lejeve të ndërtimit mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Lejet e ndërtimit datojnë prej vitit 1995.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa rezidente dhe jo-

	<p>rezidente.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sipërfaqja gjithsej në metra katrorë. • Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara në mijë lekë.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi lejet e ndërtimit të miratuara është tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2022.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve të Lejeve të Ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026 • Rregullorja e Këshillit Evropian Nr.1165/98, “Mbi treguesit Afatashkurtër”; • Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Lejeve të Ndërtimit transmetohen në EUROSTAT.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në</p>

	<p>Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Të dhënat publikohen në nivel të grupuar, sipas llojeve të ndërtesave dhe punimeve inxhinierike (referuar Klasifikimit të Ndërtimit, KN) dhe sipas qarqeve (referuar ndarjes administrative). Nuk publikohen të dhëna individuale.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018, datë 17.04.2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.

9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat e lejeve të ndërtimit publikohen në periudha kohore tremujore afërsisht 60 ditë pas përfundimit të tremujorit referues.
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të lejeve të ndërtimit. Njoftimi për shtyp i Lejeve të Ndërtimit publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e Lejeve të Ndërtimit gjenden të publikuara në botimet “ Lejet e Ndërtimit ” si dhe në “ Vjetarin Statistikor Rajonal ” në faqen e internetit të INSTAT.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: Databaza
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e Lejeve të Ndërtimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Të dhënat mikro i jepen përdoruesve të veçantë pas plotësimit të formularëve standard. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi lejet e ndërtimit të miratuara është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT mbi Statistikat Afatshkurtra, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve të lejeve të ndërtimit. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi lejet e ndërtimit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi lejet e ndërtimit për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me

	<p>parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e lejeve të ndërtimit krahasohen me të dhënat e lejeve të ndërtimit në vitet e para për të dalluar nëse ka koherence të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit mbi lejet e miratuara të ndërtimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike; • Universitetet; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me fushën e Ndërtimit për vitin 2022 janë rreth 29,354 klikime.</p> <p>Gjate 2022 INSTAT ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e statistikave në fushën e Ndërtimit është vlerësuar me 3.35 (ose 67.04%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë se Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Të dhënat e prodhuara mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë në nivelin më të detajuar të kërkuar, për numër dhe sipërfaqe për leje ndërtimit të miratuara sipas llojeve të ndërtesave; vlera e përafërt e miratuar për ndërtime dhe punime inxhinierike të miratuara; leje e ndërtimit të miratuara sipas llojit të klientit (publik ose privat). Shkalla e Plotshmërisë së të dhënave për 2022 është 100 %. Kjo përlllogaritje ka marrë në konsideratë të treguesit që prodhon INSTAT kundrejt atyre që kërkojnë nga EUROSTAT.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Informacioni mbi lejet e ndërtimit grumbullohet nga burimet administrative,</p>

	sipas detyrimit të zbatimit të bazës ligjore në fuqi mbi pajisjen me leje ndërtimi të çdo punimi të kryer (ndërtesa, punime inxhinierike). Informacioni mblidhet në mënyrë të listuar dhe nuk është objekt vrojtimi.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për përditësimet e mundshme në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Lejeve të Ndërtimit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 59 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 59 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Lejeve të Ndërtimit është 31 Dhjetori 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/28/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>59</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	2/28/2023	Afatet kohore	59		
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e publikimit	2/28/2023								
Afatet kohore	59								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Lejeve të Ndërtimit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Lejeve të Ndërtimit ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>2/28/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/28/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	2/28/2023	Data e publikimit	2/28/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	2/28/2023								
Data e publikimit	2/28/2023								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi lejet e ndërtimit janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e EUROSTAT dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi, sipas qarqeve.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi numrin, sipërfaqen dhe vlerën e lejeve të ndërtimit								

	<p>të miratuara daton nga viti 1995. Treguesi “Lloji i klientit” daton nga viti 1999.</p> <p>Duke nisur nga tremujori i parë i vitit 2016, është shtuar treguesi “Ndërtesa për zyra” ndërsa treguesi “Ndërtesa rezidente” është detajuar sipas numrit të kateve”, duke siguruar një krahasueshmeri kohore prej 7 vitesh</p> <p>(CC2=Jlast-Jfirst+1=7).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e ndryshme. Një ndër to është kontrolli që ndryshoret (variablat) si: "V411-Numri gjithsej i lejeve të ndërtimit të miratuara" dhe "V412- Sipërfaqja gjithsej e lejeve të ndërtimit të miratuara" janë koherente.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Personat që punojnë për lejet e ndërtimit janë: Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 1 punonjës; Stafi në Zyrat Rajonale: 12 punonjës.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se autoritetet lokale të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi lejet e ndërtimit do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e tremujorit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Lejet e Ndërtimit” për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale

	pranë bashkive përkatëse.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrolle logjike dhe matematike i bëhen informacionit mbi të dhënat e lejeve të ndërtimit të miratuara. Këto kontrolle kryhen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Të dhënat mbi Lejet e Ndërtimit publikohen vetëm në shifra absolute dhe janë të papërshtatura sezonalisht apo sipas ditëve kalendarike.
19. Komentë	
Aneks	